



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Pranimi / Dorezuar Prilipeno / Prifato Received / Delivered	16.09.2022	viti god year	2
Organ / Njësia Organ / Jednica Org / Unit	Nr. Prot Br. Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKDPM/SHK	5468/2022		1/3



## Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.702/2022

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës–Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave** nga: Eshref Shabani-kryetar, Ardita Haxhnikaj-Demi dhe Jeton Kocanëtarë, me Flakron Gashi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën A.nr.702/2022 të datës 12.08.2022 të parashtruar nga ankuesi me adresë banimi kundër Ministrisë së Mbrojtjes, në çështjen juridike “kontestim konkursi”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafin 1.1 si dhe neni 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 i Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 16.09.2022, mori këtë;

### V E N D I M

**Përfundon procedimi administrativ** i iniciuar me ankesën A.nr.702/2022 të datës 12.08.2022 të parashtruar nga ankuesi

### A r s y e t i m

Ministria e Mbrojtjes me datë 05.07.2022 ka shpallur konkursin me numër të Referencës: RN00009334 për pozitën e punës: “Psikolog” në kuadër të Departamentit KOMFSK, ndërsa sipas shkresave të lëndës në këtë konkurs ka aplikuar edhe ankuesi, mirëpo të njëjtit i është refuzuar aplikacioni në fazën e verifikimit paraprak.

Ankuesi, i pa kënaqur me Njoftimin e datës 10.08.2022 të Departamentit për Politikën e Personelit të Ministrisë së Mbrojtjes, me datë 12.08.2022 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës e cila është regjistruar me numër protokoll:4687/2022 me pretendimet ankimore se procedura e rekrutimit është zhvilluar në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 19.08.2022 ka proceduar kërkesën për



përgjigje në ankesën e ankuesit tek Ministria e Mbrojtjes. Ndërsa Këshilli me datë 31.08.2022 ka pranua përgjigjen në kërkesë me numër protokoli:5052/2022 së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

**Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova:** Ankesën e datës 12.08.2022 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Konkursin e datës 05.07.2022 me numër reference:RN00009334; Njoftimin e datës 04.08.2022; Ankesën e ankuesit të datës 09.08.2022; Njoftimin e datës 10.08.2022; kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 19.08.2022; Përgjigjen në kërkesë të datës 31.08.2022; kërkesën e datës 14.06.2022; Vendimin për themelimin e Komisionit i datës 02.08.2022; Listën e aplikantëve; Vendimin e Drejtorit të Departamentit për Politikat e Personelit i datës 04.08.2022; Vendimin e Drejtorit të Departamentit për Politikat e Personelit i datës 12.08.2022; Formularin për verifikimin paraprak të kandidatëve i datës 01.08.2022; Njoftimi e datës 17.08.2022 lidhur me mbajtjen e intervistës; Orarin për intervistim; Formularët për vlerësimin e kandidatëve; Listën e datës 23.08.2022 për renditjen përfundimtarëve të kandidatëve; Njoftimin për kandidatin fitues i datës 24.08.2022; Aplikacionin e ankuesit të datës 23.07.2022; Diplomën e ankuesit të datës 06.03.2013; Diplomën e datës 10.10.2017; Çertifikatën e muajit qershor 2013; Çertifikatën e lëshuar nga Shoqata "Autizmi"; Çertifikatën e datës 10.01.2018; Çertifikatën 10.01.2016; Çertifikatën e datës 25.06.2016; Akt emërimit të datës 27.11.2017; Kontratën e datës 17.12.2012; Kartelën e punës së ankuesit me shifër ASK-0050; Formularin për vlerësimin e rezultateve në punë i datës 27.01.2021; Formularin për vlerësimin e rezultateve në punë i datës 31.12.2020; Kërkesën e ankuesit të dërguar në këshill përmjet e-maili të datës 13.09.2022; Kërkesën e ankuesit të dërguar në Këshill përmjet e-maili të datës 15.09.2022.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës të dërguara nga palët në procedurë, ka konstatuar se janë plotësuar kushtet ligjore për përfundimin e procedimit administrativ lidhur me ankesën A.nr.702/2022 të ankuesit *sepse:*

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave gjatë shqyrtimit të pretendimeve ankimore të ankueses sikurse dhe analizimit të shkresave të lëndës ka gjetur se ankuesi sipas aplikacionit të datës 23.07.2022 ka aplikuar konkursin e datës 05.07.2022 me numër të Referencës: RN00009334 për pozitën e punës: "Psikolog" në kuadër të Departamentit KOMFSK, mirëpo të njëjtit i është refuzuar aplikacioni në fazën e verifikimit paraprak përmes Njoftimit të datës 04.08.2022. Po ashtu Kolegji ka gjetur se ankuesi me datë 13.09.2022 dhe datë 15.09.2022 ka parashtruar kërkesë për tërheqjen e ankesës së datës 12.8.2022 e cila në Këshill është e evidentuar me shenjën A.nr.702/2022 dhe numër protkoli:4687/2022.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në mbështetje të nenit 103 paragrafit 1 nen të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton se: "Një procedurë administrative e nisur sipas kërkesës, përfundon nëse pala që e ka bërë kërkesën e tërheq atë", ka konstatuar se janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore për përfundimin e procedimit administrativ të filluar me ankesën A.nr.702/2022 pasi që ankuesi përmes kërkesës së datës 13.09.2022 dhe kërkesës së përsëritur të datës 15.09.2022 e protokolluar e numër:5401/2022 e ka tërhequr ankesën e parashtruar me datë 12.08.2022 dhe numër protkoli:4687/2022 lidhur me kontestim e konkursit për pozitën "Psikolog" të zhvilluar nga Ministria e Mbrojtjes.



Andaj, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe konstatimeve të dhëna në pasqyrimin e këtij vendimi si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafin 1.1 si dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

## Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës

Lënda me numër A.nr.702/2022

**Flakron GASHI**

  
Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional



### Vendimi i dërgohet

- Ankuesit
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Mbrojtjes;
- Udhëheqësit të Personelit në Ministrinë e Mbrojtjes;
- Arkivit të KPMSHCK-së

